



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Tekniks M” Sh.P.K. të datës 23.08.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 13.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me kontenjer për mbeturina” me nr. të prokurimit 616-23-7124-1-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET si e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Tekniks M” Sh.P.K. të datës 23.08.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 13.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me kontenjer për mbeturina” me nr. të prokurimit 616-23-7124-1-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues për të publikuar formularin për korigjimin e gabimeve në njoftimeve të publikuara përmes të cilit do të bëj ndryshim/plotësimin e dosjes së tenderit sipas të gjeturave në këtë vendim dhe në përputhje të plotë me LPP.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik “Bujar I. Kabashi” B.I. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Tekniks M” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 23.08.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të datës 13.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me kontenjer për mbeturina” me nr. të prokurimit 616-23-7124-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

- *“Autoriteti Kontraktues te kapaciteti teknik dhe profesional ka kerkuar qe mostrat te sillen fizikisht. Mendojm qe ky kriter eshte diskriminues sepse te gjitha keto ne i mbulojm me ISO 9001, ISO 14001, ISO 50001, DIN EN 840-2, EN 14803 dhe DIN 30745 dhe Katallogu”.*

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet cekur se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Në këtë kontekst sektori i prokurimit ka kërkuar nga njësia kërkuese që të bëjë vlerësimin fillestar të pretendimeve ankimore. Rrjedhimisht me datë 23.08.2023 njësia kërkuese ka dërguar përgjigjet si në vijim:

1. *“Sa i perket standardit te kerkuar ISO 50001 largohet nga kerkesa”.*
2. *“Sa i perket mostrave eshte kerkuar qe te dorezohen per pozicionet 1, 2, 3, 4 nga një mostër sipas psecifikave”.*

Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese.

Vlen të theksohet se dëshmitë për certifikatat ISO janë një kërkesë tjetër në dosjen e tenderit ndërsa kërkesa për të dorëzuar mostrat për pozicionet 1, 2, 3 dhe 4 është kërkesë tjetër në dosjen e tenderit. Këto dy kërkesa jo domosdoshmërisht janë të ndërlidhura me njëra tjetrën. Prandaj argumenti i parashtruesit se njëra kërkesë e mbulon tjetrën nuk është i qëndrueshëm. Kërkesa për certifikatat ISO janë dëshmitë për standardin minimal të kërkuar për produktet në fjalë ndërsa dorëzimi i mostrave do t'i mundësojë komisionit vlerësues për të ekzaminuar, krahasuar dhe vlerësuar tenderët në këtë aktivitet të prokurimit. Rrjedhimisht është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë të pabazuara.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Për këto arsye është miratuar si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin b) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 25.08.2023

Visar SHEHU



Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.